



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____._____.2022

VENDIM

Nr. 546, datë 22.12.2022

PËR

SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR QËNDRIM NË DETYRË DERI NË MOSHËN 70 VJEÇ TË Z. {...}, GJYQTAR PRANË GJYKATËS SË APELIT SHKODËR

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 61 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar dhe në pikën 5 të nenit 64 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pas shqyrtimit të kërkesës për qëndrim në detyrë të gjyqtarit deri në moshën 70 vjeç, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Miratimin e qëndrimit në detyrë të magjistratit z. {...} deri në moshën 70 vjeç, sipas Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
3. Efektet juridike të vendimit fillojnë më datë 24.02.2023.
4. Një kopje e vendimit i njoftohet magjistratit, gjyqtarit z. {...}, Gjykatës së Apelit Shkodër dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR